

RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 01



GUSHT 2021



RINGJALLJE

INVESTIM

MBËSHTETJE

QËNDRUESHMËRI

KOORDINIM

PUNËSIM

MIRËQENIE

BARAZI

JETËSIM

EKONOMI

→ Për Buletinin

Buletini "Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri" është pjesë e projektit "Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri". Ky projekt ka për qëllim të promovojë një perspektivë të Agjendës së Gjelbër në pakot e ardhshme të rimëkëmbjes, të monitorojë zbatimin e masave nxitëse dhe të sigurojë një mënyrë të dobishme për qytetarët që të përfshihen në diskutim duke përfitur nga teknologjia e informacionit. Gjithashtu, projekti synon të avancojë kushtet në të cilat pakot aktuale dhe të ardhshme të rimëkëmbjes të ndikojnë në sektorët më të prekur të ekonomisë dhe të shoqërisë së prekur nga efektet e pandemisë.

Kjo seri e Buletineve ka për qëllim informimin e qytetarëve rreth masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, monitorimin e zbatueshmërisë së tyre si dhe akterët përfitues të këtyre masave.

Gjithashtu, përmes këtyre buletineve qytetarët do kenë mundësi të informohen rreth shumave që do të alokohen për secilën masë të paraparë përmes kësaj pako dhe pakove që do miratohen në vazhdim. Qëllimi kryesor i këtyre masave është padyshim zvogëlimin e ndikimeve negative që

ka shkaktuar pandemia në ekonominë e Kosovës, dhe përmes këtyre masave synohet që të rikthehet normaliteti ekonomik.

Edicioni i parë i buletinit përmban një përshkrim të tërësishëm të masave të përcaktuara në Pakon e Ringjalljes Ekonomike. Duke monitoruar zbatimin e kësaj pako dhe pakove tjera pasuese, ky buletin dhe buletinët e rradhës, INDEP do të informojnë publikun për zbatimin e pakos duke ndikuar kështu në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies mes institucioneve relevante dhe qytetarëve të Kosovës. Përmes këtyre buletineve ne do shpalosim detajet rreth këtyre mundësive të ofruara me qëllim të rimëkëmbjes së vendit. Këto buletinë kanë për qëllim të japin informacion të përmbledhur dhe të nevojshëm për akterët kryesorë, si dhe qytetarët në lidhje me statusin e zbatimit të masave që rezultojnë nga Pako e Ringjalljes. Për më tepër, buletinet do të shërbejnë për të informuar dhe udhëzuar këta akterë përkatës në lidhje me elementët e rinj të shtuar në Barometrin e Rimëkëmbjes 2.0.

→ Pako e Ringjalljes Ekonomike

Dëmet nga Pandemia COVID-19, kanë lënë gjurmë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbesin ende të riparueshme. Dëmet e shkaktuara si rezultat i mbylljeve të tërësishme të vendit dhe masave tjera parandaluese ndaj përhapjes së pandemisë janë të mëdha. Sektorë të ndryshëm kanë pësuar humbje të mëdha të cilat janë vështirë të rikthyeshme. Si rrjedhojë e gjithë këtyre zhvillimeve, Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve ka hartuar pakon e tretë me rradhë e cila parasheh rritjen e aktivitetit ekonomik, e me këtë edhe korrigjimin e deformimeve ekzistuese në strukturën e Prodhimit Bruto të Brendshëm.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 16 Korrik 2021, miratoi në parim Projektligjin nr.08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për

buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Ndërsa me datë 28 Korrik 2021, Kuvendi i Republikës së Kosovës mbajti seancën plenare, ku në rend të ditës ishte shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në po të njëjtën datë, miratoi Ligjin Nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Kjo pako përmbanë në vete masat përmes të cilave do të u ofrohet ndihmë sektorëve të dëmtuar si pasojë e pandemisë COVID-19. Në tërësi këto masa janë të kategorizuara në pesë kategori të cilat përfshijnë sektorë të ndryshëm. Këto masa janë:

1. Mbështetja e punësimit



2. Ringjallja e ekonomisë dhe prodhimit



3. Mbështetja për familjen



4. Mbështetja për publikun



5. Investimi në infrastrukturë dhe ambient



Shuma e përgjithshme e Pakos së Ringjalljes Ekonomike është 420 milionë euro. Kjo pako do të financohet nga buxheti i Kosovës përmes 190 milionë eurove, ndërsa 230 milionë euro të tjera janë të paraqitura si financim nga huamarrja. Në kuadër të këtyre masave dhe veprimeve për ringjalljen ekonomike të vendit është edhe emetimi i Bonove të Diasporës, të cilat mjete do të përdoren për financimin e këtyre masave.

Masa 1 → Mbështetja e punësimit

Përmes kësaj mase, Qeveria e Republikës së Kosovës synon që të mbështesë qytetarët të cilët kanë humbur vendet e punës si pasojë e pandemisë COVID-19, dhe atyre që kanë kërkuar vende pune. Kjo do të arrihet duke krijuar vende të reja pune dhe duke krijuar kushte për rikthimin e punëtorëve në pozitat paraprake. Në total, kjo masë ka të parashi-kuara 50 milionë Euro, shumë e cila do të ndahet në disa kategori.

50 MILIONË EURO PËR
PËRKRAHJE TË PUNËSIMIT



MASA 1

10 mil
EUR

10 mil
EUR

10 mil
EUR

5 mil
EUR

5 mil
EUR

5 mil
EUR

5 mil
EUR

1.1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë

1.2. Mbështetja për të punësuarit e formalizuar

1.3. Mbështetja e punësimit të grave

1.4. Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë

1.5. Trajnimi dhe punësimi në TI


1.6. Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta

1.7. Skema e granteve për zanatet

Masa 2 → Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit

Masa e dytë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, synon të mbështesë dhe të inkurajojë investimet në teknologji dhe inovacion, prodhimtari dhe eksport, duke ndihmuar kështu bizneset e prekura nga pandemia në mënyra të ndryshme. Kjo masë parasheh të ndajë 108 milionë Euro, me qëllimin e vetëm, që të shtyjë përpara këto kategori të ndikuara dhe të dëmtuara. Përmes kësaj mase kategori mjaft të rëndësishme do të mbështeten, ku me këtë rast do të lehtësohet rimëkëmbja ekonomike e vendit.

108 MILIONË EURO PËR
RINGRITJE TË EKONOMISË
DHE PRODHIMTARISË




Masa 3 → Mbështetja për familjen

Pandemia COVID-19 ka dëmtuar mirëqenien sociale. Shumë familje janë prekur dhe janë dëmtuar ekonomikisht por edhe moralisht e fizikisht. Të gjitha këto kanë sjellur dëme të cilat pa ndihmën e jashtme vështirë se do të mund të rikthehen si më parë. Kjo ka bërë që në Pakon e Ringjalljes Ekonomike të përfshihet edhe masa e cila është e dedikuar për ndihmën ndaj familjeve, sidomos atyre më të prekura. Kjo ndihmesë tenton që sadopak të lehtësojë dëmet e shkaktuar si pasojë e pandemisë.

50 MILIONË EURO
MBËSHTETJE PËR
FAMILJET


MASA 3




Masa 4 → Mbështetja për publiken

Mirëqenia sociale ndikon shumë në produktivitetin dhe arritjet qytetare. Me shfaqjen e pandemisë dhe gjatë saj, ky sektor u ndikua shumë, ku për pasojë edhe stagnoi në shumë drejtime. Shëndetësia, arsimi, kultura dhe sporti, por edhe siguria janë ndër fushat më të prekura. Andaj është vendosur që kjo pako të përfshijë edhe sektorët e lartpërmendur, me ndihma në vlerë prej 112 milionë Euro.

112 MILIONË EURO PËR
MBËSHTETJE PUBLIKE



MASA 4



Masa 5 → Investimi në infrastrukturë dhe ambient

Pako e Ringjalljes Ekonomike ka paraparë mbështetje edhe për infrastrukturën dhe ambientin. Gjithsej kjo masë përmban 100 milionë Euro investime. Këto investime kanë të bëjnë me projekte në infrastrukturën rrugore, hekurudhore e po ashtu edhe në mbrojtjen e ambientit. Sa i përket investimeve në mbrojtjen e ambientit, ato do të fokusohen në eficiencë dhe energji elektrike. Në kuadër të ambientit, thuhet në Pakon e Ringjalljes Ekonomike se janë ende duke u negociuar me akterë dhe investitorë të ndryshëm për të sjellur investime në këtë drejtim.

**MBËSHTETJA E
PUNËSIMIT**



**RINGJALLJA E EKONOMISË
DHE PRODHIMIT**



**MAS
RINGJAL
EKONO
420 M**

**MBËSHTETJE
FAMILJARE**

**100 MILIONË EURO PËR
INFRASTRUKTURËN DHE
AMBIENTIN**



**AT E
ALLJES
OMIKE
ILIONË**



**INVESTIMI NË
INFRASTRUKTURË
DHE AMBIENT**



**MBËSHTETJA PËR
PUBLIKEN**

**ETJA PËR
LJEN**



Ky buletin u përgatit me mbështetjen e Balkan Trust for Democracy, një projekt i German Marshall Fund e SH.B.A.-së dhe USAID. Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy, German Marshall Fund e SH.B.A.-së, USAID ose të qeverisë Amerikane.